



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Data 11.11.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Pajisje elektronike dhe kompjuterike” i ndarë sipas loteve:

Loti 1 - Pajisje elektronike (kompjuter, printer, server, etj)

Loti 2 - Materiale per funksionimin e paisjeve elektronike (paisje kompjuterike)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pajisje kompjuterike dhe furnizime 30200000-1

Kompjuterat portativ 30213100-6

Kompjuterat tablet 30213200-7

Kompjuterat desktop 30213300-8

Printer laser 30232110-8

Pajisje elektronike 31710000-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,920,900 (dy milion e nentëqind e njëzet mijë e nentëqind) lek, pa tvsh, i ndarë sipas loteve:

Loti 1 - Pajisje elektronike (kompjuter, printer, server, etj): 2 580 000 (dy milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, pa tvsh.

Loti 2 - Materiale per funksionimin e paisjeve elektronike (paisje kompjuterike): 340 900 (treqind e dyzet mijë e nentëqind) lekë, pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KORÇË ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të fondit të limit të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e të vlerës së fondit të limit të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur Çertifikatën ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit të cilësive” ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar në procesverbalin e mbajtur prej tij 7335/1 Prot, datë 04.11.2025 si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për çertifikatën e mesiperme është konsideruar e nevojshme, duke patur parasysh natyrën dhe vlerën e objektit të prokurimit, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi

permbushin standartin e cilesise per te cilen leshohet kjo çertifikate me qellim qe autoriteti kontraktor te vertetoje permbushjen e kontrates ne perputhje me standartet e cilesise.

2.3.2 Për të vertetuar se përmbush specifikimet e kërkuara Operatori Ekonomik duhet te paraqese **katalogun teknik ose skedat teknike** për produktet e mëposhtme:

1	Printer all in one (black and white) Machine A4
2	Printer all in one (black and white) MFP Basic
3	Kompjuter all in one
5	UPS Online
6	Inverter
7	Bateri Lithium
8	Access Controller
9	Server
10	Core Switch
11	Pajisje zeri
13	Printer portabel

Në katalog apo skedat teknike, duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të kërkuara në specifikimet teknike të publikuara me dokumentat e tenderit.

Ne rast se dokumentet e mesiperme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij 7335/1 Prot, date 04.11.2025 si me poshte:

Ky kriter vendoset bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, gërma b të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku parashikohet shprehimisht: *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo **katalogjet teknike***

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë autoritetit kontraktor që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to.

1 KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës të fondit të limit të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 2c dhe 55 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e të vlerës së fondit të limit të lotit që prokurohet.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohet në të gjitha lotet ku merr pjesë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur Çertifikatën ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit të cilësive” ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter u vendos nga grupi i punës i argumentuar ne procesverbalin e mbajtur prej tij 7335/1 Prot, date 04.11.2025 si me poshte:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kerkesa per çertifikaten e mesiperme eshte konsideruar e nevojshme,duke patur parasysh natyren dhe vleren e objektit te prokurimit, per vertetuar se operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne kete procedure prokurimi permbushin standartin e cilesise per te cilen leshohet kjo çertifikate me qellim qe autoriteti kontraktor te vertetoje permbushjen e kontrates ne perputhje me standartet e cilesise.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i punës i ngritur me udhrin e Kryetarit Nr 832 date 28.07.2025 sipas procesverbalit nr.7335/1 prot date 04.11.2025, te mbajtur prej tij.

Argumentimi i specifikimeve Loti I: *Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja per pajisje elektronike dhe kompjuterike të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Konkretisht:

1. **UPS Online/Inverter/Bateri Lithium:** Specifikimet teknike për UPS Online 6 kVA/6 kW, Inverter 8 kW (48 VDC) dhe Bateri Lithium LiFePO₄ 48V 100Ah janë përcaktuar për të garantuar siguri të plotë energjetike dhe funksionim të pandërprerë të sistemeve IT, serverëve dhe pajisjeve elektronike të Bashkisë. Kërkesa për UPS të tipit Double Conversion (VFI) siguron mbrojtje të vazhdueshme 24/7 ndaj ndërprerjeve të energjisë dhe luhatjeve të tensionit, duke eliminuar çdo vonesë në kalimin në furnizimin me bateri (0 ms). Parametrat si efikasitet $\geq 94\%$, forma e valës “pure sine wave”, dhe faktori i fuqisë 1.0 janë standarde ndërkombëtare për pajisje kritike, që ruajnë stabilitetin e tensionit dhe mbrojnë nga dëmtimet elektronike. Integrimi i komunikimit SNMP/HTTP/RS-232 dhe panelit LCD mundëson monitorim të plotë në kohë reale, ndërsa bypass-i automatik dhe manual garantojnë vazhdimësi në rast mirëmbajtjeje apo defekti.

Inverteri dhe bateritë plotësojnë funksionin e UPS-it, duke mundësuar furnizim alternativ jashtë rrjetit ose në kushte emergjente. Inverteri me fuqi 8 kW dhe formë vale sinusoidale të pastër (pure sine wave) ofron furnizim të qëndrueshëm për ngarkesa të ndjeshme, ndërsa bateritë LiFePO₄ 48V 100Ah sigurojnë autonomi 5–15 minuta dhe jetëgjatësi mbi 10 vjet me mbi 4000 cikle karikimi/shkarkimi. Përdorimi i teknologjisë LiFePO₄ ofron efikasitet të lartë, ngarkim të shpejtë, siguri termike dhe mirëmbajtje minimale, duke reduktuar kostot operative afatgjata.

Kërkesa që pajisjet të përfshijnë kabllot dhe aksesoret e nevojshëm për lidhje ndërmjet tyre është vendosur për të siguruar instalim të plotë, funksionalitet të menjëhershëm dhe kompatibilitet të garantuar të sistemit të energjisë rezervë, në përputhje me standardet IEC dhe praktikat më të mira për mbrojtjen e infrastrukturës IT institucionale.

2. **Server:** Specifikimet teknike për serverin janë përcaktuar për të siguruar performancë të lartë, siguri të vazhdueshme dhe ruajtje të qëndrueshme të të dhënave, në përputhje me kërkesat institucionale të Bashkisë për sistemet e brendshme IT dhe bazat e të dhënave. Përcaktimi i dy procesorëve me vlerësim minimal 14 000 pikë secili sipas cpubenchmark.net, RAM 128 GB DDR4 ECC dhe konfigurimi RAID për SSD dhe SAS garanton kombinim optimal midis shpejtësisë së përpunimit dhe sigurisë së të dhënave. RAID 1 për sistemin operativ ofron mbrojtje nga humbja e informacionit në rast defekti të një disku, ndërsa RAID 5 për hapësirën e të dhënave mundëson efikasitet dhe performancë të balancuar. Përdorimi i kontrollerit RAID hardware SAS 12G me cache 8 GB dhe disqeve “Hot Swap” siguron mirëmbajtje pa ndërprerje dhe fleksibilitet të plotë në zëvendësim komponentësh. Forma fizike Rack Mount 2U lejon instalim të standardizuar në kabinetet ekzistuese të qendrës së të dhënave.

Nga ana e sigurisë dhe lidhjes, serveri parashikohet me 4 porta Gigabit LAN, portë menaxhimi GbE, dhe modul TPM 2.0, duke garantuar mbrojtje të avancuar ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara dhe menaxhim të centralizuar të rrjetit. Kërkesa për burime të dyfishta energjie (2x800W PSU hot swap) siguron funksionim të vazhdueshëm edhe në rast defekti të një furnizuesi. Përfshirja e sistemit operativ të licencuar Windows Server 2022 Standard mundëson përdorim ligjor dhe përputhshmëri me platforma të tjera si Red Hat, SUSE dhe VMware, duke garantuar fleksibilitet në virtualizim dhe administrim. Pajisja kërkohet e shoqëruar me shina për instalim në rack për integrim të plotë fizik dhe me garanci 3-vjeçare, që siguron mbulim gjatë gjithë ciklit të pritshëm të përdorimit. Këto parametra përbëjnë minimumin teknik të nevojshëm për një infrastrukturë serverike institucionale moderne, që siguron siguri të të dhënave, efikasitet dhe mirëmbajtje të lehtë.

3. **Printer portabel (per përdorim me pajisjen svantek 973):** Specifikimet teknike për Printerin Portabël për pajisjen Svantek 973 janë përcaktuar për të garantuar përputhshmëri të plotë funksionale me instrumentin ekzistues të matjes së zhurmës SVANTEK 973, i cili përdor komunikim RS-232 serial për gjenerimin dhe printimin e raporteve të matjes. Kërkesa që printeri të mos ketë vetëm portë USB, por të disponojë ndërfaqe RS-232 (DB9 ose ekuivalente), është thelbësore pasi instrumenti nuk e mbështet komunikimin përmes USB-së dhe kërkon protokollin klasik 8N1 (8 data bits, No parity, 1 stop bit). Po ashtu, mundësia e konfigurimit të baud rate (deri në 9600 bps ose më shumë) garanton përshtatshmëri me parametrat e transmetimit të pajisjes matëse. Printeri duhet të jetë në gjendje të pranojë tekst ASCII të thjeshtë nëpërmjet ndërfaqes seriale, pa pasur nevojë për gjuhë shtesë programimi si PCL apo ESC/POS, duke bërë të mundur riprodhimin e drejtpërdrejtë të raporteve të matjeve në terren.

Në aspektin fizik dhe operativ, printeri kërkohet termik portabël me gjerësi letre 58 mm ose 80 mm, rezolucion tipik 203 dpi dhe shpejtësi printimi 50–100 mm/s, duke mundësuar prodhim të shpejtë dhe të lexueshëm të rezultateve. Përdorimi i baterisë së integruar Li-ion me mundësi karikimi përmes adapterit 220 V ose USB ofron pavarësi të plotë gjatë matjeve në terren. Kërkesa për peshë nën 1 kg, dimensione kompakte dhe mbrojtje IP54 ndaj pluhurit e spërkalave garanton

lehtësi transporti, rezistencë ndaj kushteve të jashtme dhe përdorim praktik për inspektorët e mjedisit. Këto specifikime përfaqësojnë minimumin teknik të nevojshëm për të siguruar integritet të drejtpërdrejtë dhe funksionim pa ndërmjetës me pajisjen ekzistuese të matjes së zhurmës, në përputhje me kërkesat standarde të fushës akustike dhe të inspektimeve në terren.

4. **Pajisje zeri (Matësi i nivelit të zërit):** Specifikimet teknike për pajisjen e matjes së nivelit të zërit (Sound Level Meter) janë përcaktuar për të siguruar një instrument profesional, të certifikuar dhe të përshtatshëm për matjet akustike zyrtare në përputhje me standardin ndërkombëtar IEC 61672-1:2013, Klasa 2. Përdorimi i filtrave të peshimit A, C dhe Z, konstanteve kohore i ngadalshëm, i shpejtë dhe impuls, si dhe detektorit dixhital True RMS me rezolucion 0,1 dB, garanton saktësi të lartë në matjen e niveleve të zhurmës në mjedise urbane, industriale apo sociale. Mikrofonit MEMS ST 973A ½ inch me parapërforsues të integruar siguron ndjeshmëri dhe stabilitet në kushtet atmosferike të ndryshme, ndërsa gama e matjes prej 25–141 dBA dhe diapazoni i frekuencës 20 Hz – 10 kHz përmbushin plotësisht kërkesat ligjore për monitorimin e ndotjes akustike. Pajisja mbështet matje të njëkohshme në tre profile të pavarura dhe regjistrim të parametrave kryesorë si LEQ, Lpeak, Lmax, Lmin, Dose dhe TWA, duke mundësuar analiza të detajuara të ekspozimit ndaj zhurmës.

Në aspektin funksional, instrumenti përfshin regjistruar të të dhënave, memorie të brendshme 8 GB, ekran OLED me ngjyra, si dhe ndërfaqe komunikimi USB-C dhe Bluetooth 5.2 për shkarkim e transmetim të të dhënave. Pajisja operon me bateri AAA alkaline ose NiMH dhe ofron autonomi 20–38 orë, e përshtatshme për matje në terren. Opsionet për analizë 1/1 dhe 1/3 oktavë, regjistrim audio në format WAV dhe komente zanore sigurojnë gjurmueshmëri të plotë të matjeve. Përfshirja e printerit portabël është kërkesë e domosdoshme për printim të menjëhershëm të rezultateve në terren, ndërsa çertifikata e kolaudit është e detyrueshme për të garantuar vlefshmërinë ligjore dhe teknike të matjeve të zhurmës. Këto parametra përbëjnë nivelin minimal profesional të nevojshëm për një pajisje akustike të certifikuar të përdorshme nga strukturat e mjedisit në Bashkinë Korçë për monitorimin dhe verifikimin e ndotjes akustike në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Specifikimet teknike të pajisjeve: **Printer all in one (black and white) Machine A4, Printer all in one (black and white) MFP Basic, Kompjuter all in one, Core Switch (Switch L3 me 24 porta) dhe Access Controller (Sistem Akses Kontrolli)** janë hartuar në përputhje të plotë me Standardet TIK 2025, të miratuara dhe publikuara nga **Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)** në dokumentin “**Specifikimet Teknike Standarde për vitin 2025**”. Këto standarde përcaktojnë kërkesat minimale për pajisjet elektronike dhe infrastrukturore që përdoren në administratën publike, me qëllim sigurimin e interoperabilitetit, efikasitetit energjetik, sigurisë kibernetike dhe performancës së qëndrueshme. Përcaktimet e përfshira në dosjen teknike janë në përputhje me këto udhëzime standardizuese dhe synojnë unifikimin teknologjik të pajisjeve TIK në nivel institucional, duke garantuar përputhshmëri të plotë me arkitekturën dhe politikën digjitale shtetërore të miratuara nga AKSHI.

Argumentimi i specifikimeve Loti II: Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për pajisje elektronike dhe kompjuterike të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Konkretisht:

Specifikimet teknike të këtyre pajisjeve dhe aksesorëve IT janë përcaktuar për të garantuar mirëfunksionimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e infrastrukturës ekzistuese teknologjike të rrjetit dhe pajisjeve të Bashkisë, **në përputhje me Standardet TIK 2025 të miratuara nga AKSHI dhe me kërkesat minimale teknike të nevojshme për mjedise institucionale.** Elementet si kokat e rrjetit RJ45, kabujt LAN dhe patch cord-et në gjatësi të ndryshme (20 cm deri në 15 m) sigurojnë lidhje të qëndrueshme dhe fleksibilitet në ndërtimin e rrjetit kabllor, duke mundësuar konfigurim dhe mirëmbajtje efikase të kabinetëve të rrjetit, serverëve dhe stacioneve të punës. Kartat e rrjetit 10Gb dhe 1Gb me 4 porta janë të domosdoshme për rritjen e shpejtësisë së transmetimit të të dhënave në serverët dhe switch-et e nivelit të lartë, duke përmirësuar ndjeshëm performancën e komunikimit brenda rrjetit lokal institucional.

Aksesorët si kabujt HDMI (5m dhe 10m), stendat e projektorëve, web kamerat dhe kufjet janë përzgjedhur për të përmbushur nevojat e komunikimit dhe prezantimeve dixhitale në takime, trajnime apo aktivitete publike, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e bashkëpunimit. Komponentët e brendshëm si RAM DDR4 16GB, HDD 4TB dhe SSD 1TB janë të nevojshëm për zgjerimin dhe përmirësimin e pajisjeve ekzistuese kompjuterike e serverike, duke garantuar ruajtje të mjaftueshme të të dhënave, shpejtësi përpunimi dhe qëndrueshmëri operative. Kabujt optikë fiber 10Gb me adaptorë 10 m mundësojnë komunikim me shpejtësi shumë të lartë ndërmjet pajisjeve të rrjetit, në përputhje me kërkesat për lidhje “backbone” në infrastrukturën TIK bashkiake. Po ashtu, USB-të për printerë sigurojnë lidhje të standardizuar dhe të besueshme ndërmjet pajisjeve të printimit dhe stacioneve të punës. Në tërësi, këto specifikime përfaqësojnë nivelin minimal teknik për modernizimin, sigurinë dhe integritetin e rrjetit të brendshëm informatik të Bashkisë Korçë, në përputhje me politikat kombëtare të transformimit digjital.

Në respektim të nenit 36 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës bëhen pjesë e dokumentave të tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT